



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 663 prot.

Pukë, më 23.03 2022

PROJEKT - VENDIM

Nr. 24 Datë 23.03 .2022

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 48 DATË 30.12.2021 “ PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË BASHKISË PUKË , NJESIVE ADMINISTRATIVE , INSTITUCIONEVE TË VARËSISË DHE FUNKSIONEVE TË DELEGUARA PËR VITIN 2022”

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 ,”Për vetëqeverisjen vendore”, udhëzimit nr.21, datë 23.7.2010 “Për normat e punës mësimore-edukative dhe numrin e nxënësve për klasë në institucionet e arsimit parauniversitar” i ndryshuar dhe vendimit nr. 1149, datë 24.12.2020 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë, në arsimin parauniversitar”, të ndryshuar, në vendimin nr. 48 datë 30.12.2021 “ Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të bashkisë Pukë , njesive administrative , institucioneve të varësisë dhe funksioneve të deleguara për vitin 2022” me propozimin e Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Drejtorisë së Administrimit të Përgjithshëm dhe me propozimin e Kryetarit të Bashkisë:

VENDOSI:

1. Ndryshimin e emërimit të pozicionit të punës nga drejtor në përgjegjës , të drejtorit të Qëndres Kulturore të Fëmijëve , mbështetur në Udhëzimin nr. 21, datë 23.7.2010 “Për normat e punës mësimore-edukative dhe numrin e nxënësve për klasë në institucionet e arsimit parauniversitar” i ndryshuar.
2. Ndryshimin e emërimit të pozicionit të punës të drejtorit të konviktit “Ali Bytyqi” në përgjegjës bazuar në vendimin nr. 1149, datë 24.12.2020 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë, në arsimin parauniversitar”, të ndryshuar.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55 pika 6, e ligjit nr.139/2015 “Për Veteqeverisjen Vendore”.

Drejtor DMBNJ
Emirjona Pergjegjaj

Jurist
Aida Sinani

KRYETARI
Gjon GJONAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 663/1 prot.

Pukë, më 23.03.2022

Relacion

PËR MIRATIMIN E PROPOZIMIT PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 48 DATË 30.12.2021 “ PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË BASHKISË PUKË, NJESIVE ADMINISTRATIVE , INSTITUCIONEVE TË VARËSISË DHE FUNKSIONEVE TË DELEGUARA PËR VITIN 2022”

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 ,”Për vetëqeverisjen vendore”, udhëzimit nr.21, datë 23.7.2010 “Për normat e punës mësimore-edukative dhe numrin e nxënësve për klasë në institucionet e arsimit parauniversitar” i ndryshuar dhe vendimit nr. 1149, datë 24.12.2020 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë, në arsimin parauniversitar”, të ndryshuar, në vendimin nr. 48 datë 30.12.2021 “ Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të bashkisë Pukë , njesive administrative , institucioneve të varësisë dhe funksioneve të deleguara për vitin 2022” me propozimin e Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Drejtorisë së Administrimit të Përgjithshëm dhe me propozimin e Kryetarit të Bashkisë:

Të bëhen ndryshimet e mëposhtme në zbatim të ligjeve në fuqi përkatës për arsyt se numri i nxënësve nuk përbën normen e duhur për këto pozicione pune si më poshte :

1. Ndryshimin e emërimit të pozicionit të punës nga drejtor në përgjegjës , të drejtorit të Qëndres Kulturore të Fëmijëve , mbështetur në Udhëzimin nr. 21, datë 23.7.2010 “Për normat e punës mësimore-edukative dhe numrin e nxënësve për klasë në institucionet e arsimit parauniversitar” i ndryshuar.
2. Ndryshimin e emërimit të pozicionit të punës të drejtorit të konviktit “Ali Bytyqi” në përgjegjës bazuar në vendimin nr. 1149, datë 24.12.2020 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë, në arsimin parauniversitar”, të ndryshuar.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55 pika 6, e ligjit nr.139/2015 “Për Veteqeverisjen Vendore”.

Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore
Emirjona Pergjegjaj